




KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

NPL EKO THERANDA SH.A.	
Nr.	34-2025
Data	24.06.2025
 NPL EKO-THERANDA	

NPL "EKO-THERANDA"
SH.A. SUHAREKË

RREGULLORE PËR PAGAT, SHTESAT NË PAGË
DHE KOMPENZIME TË TJERA TË
PUNONJËSVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE
LOKALE "EKO THERANDA" SH.A.

Suahrekë 2025

A. Në bazë të dispozitave të nenit 130, lidhur me nenin 159, të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018" e në mbështetje të Vendimit për emërim të Bordit të Drejtoreve të "Eko-Theranda" SH.A nga Suhareka, me qëllim të jetësimit të misionit të tij, në realizimin e përgjegjësive që ka Bordi i Drejtoreve, sipas dispozitave të nenit 34, lidhur me nenin 22 të Ligjit Nr-03/L-87, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr-31/15, qershori 2008) dhe dispozitave të nenit 20, lidhur me nenin 12, të Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërmarrjet publike, Nr-03/L-087, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr-13/15, qershori 2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, Bordi i Drejtoreve i "Eko-Theranda" SH.A. në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.06.2025, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR PAGAT, SHTESAT NË PAGË DHE KOMPENZIME TË TJERA TË PUNONJËSVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "EKO THERANDA" SH.A.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A, që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A, si dhe të krijojë një sistem të pagave, kompensimeve dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë mbi bazën e performancës së Ndërmarrjes.

Neni 2 Fushëveprimi

- 1.Kjo Rregullore zbatohet për të punësuarat në Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A, pagat e të cilëve financohen nga dhe përmes buxhetit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A. dhe buxhetit të Komunës.
2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të tëpunësuarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A, janë ekskluzivisht rregullim i kësaj Rregullore dhe mund të rregullohen edhe me vendime të tjera të Bordit të Drejtoreve, vetëm kur parashihet shprehimi nga kjo Rregullore dhe me Ligj specifik.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë Rregullore, shprehjet/fjalët kanë këtë kuptim:

- 1.1 **Paga bazë** – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përpunhje me shtojcën e kësaj Rregullore;
- 1.2 **Paga mujore apo paga** – nënkupton kundërvlerën monetare që përfshin pagën bazë, shtesat dhe të drejtat e tjera të pagës, që për qëllimin e kësaj Rregullore trajtohet si pagë primare;

- 1.3 Klasa e pagës - nënkupton nivelin e pozicionimit në hierarkinë e përgjithshme të funksioneve në shkallën e pagës e që i korrespondon koeficienti i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë;
- 1.4 Koeficienti i pagës apo koeficienti – nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion;
- 1.5 Kompensim - nënkupton pagesën në formën e mbulimit të shpenzimeve të kryera apo që do të kryhen nga i punësuari, për udhëtime, qëndrim apo përfaqësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, apo kompensimi për punë gjatë natës, jashtë orarit të punës dhe kompensimi për kujdestari;
- 1.6 Shpërblim - nënkupton kundërvlerën monetare për një punë të kryer nga anëtarë i një organi kolegjal me kohë jo të plotë, që për qëllimin e kësaj Rregullore trajtohet si pagë sekondare;
- 1.7 Shtesë page apo shtesë - nënkupton komponentin e pagës që i shtohet pagë bazë dhe që synon të shpërblejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specializime të veçanta dhe që nuk shpërblehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet për çdo muaj apo e parregullt kur shpërblehet sipas rastit në bazë të kësaj Rregullore.
- 1.8 Udhëtim zyrtar nënkupton- udhëtimin i cili ka destinacion apo qëllim që shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A me seli në Suharekë.

Neni 4 Parimet e sistemit të pagave

1. Sistemi i pagave i rregulluar me këtë Rregullore bazohet në parimet e mëposhtme:

- 1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se e drejta në pagë përcaktohet në përputhje me dispoziat e kësaj Rregullore dhe me aktet e Bordit të Drejtorëve të autorizuara dhe të nxjerra në zbatim të saj;
- 1.2. Parimi i transparencës – nënkupton që përcaktimi i pagës dhe të drejtave të tjera që burojnë nga paga, është informacion me interes publik dhe trajtohet në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 1.3. Parimi i parashikueshmërisë – nënkupton se niveli i pagës, i përcaktuar sipas kësaj Rregullore, mund të ulet, vetëm nënë përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të NPL-së të përgatitur dhe të zbuluar nga Komisioni i Auditimit sipas nenit 20.4 të Ligjit për ndërmarrjet publike;
- 1.4. Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit – nënkupton që secili, pa kurrifare diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkosat për vendin e punës, institucionin ku ushtronhet detyra si dhe kualifikimin.

Neni 5 Burimi i pagës

Mjetet financiare për pagat, shtesat, shpërbimet dhe kompensimet tjera të tëpunësuarëve që janë subjekt i kësaj Rregullore, sigurohen nga dhe përmes buxhetit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Theranda" SH.A. dhe buxhetit të Komunës Suharekës.

Neni 6 Paga, kompensimii pagës dhe tëardhuratë tjera

1. Paga bazë e të punësuarëve në NPL "Eko-Theranda" Sh.A., është ajo pjesë e pagës që përsiton i punësuari për punën e kryer në një pozitë të caktuar.

2. Paga bazë e të punësuarëve përcaktohet nga Grupi i Pagës të cilës i përket sipas Shtojcës Nr. 1 bashkëngjitur e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.
3. Pagat në Republikën e Kosovës paguhën sipas valutës zyrtare në Euro (€).

Neni 7 Paga bazë e punonjësit

1. Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcën e kësaj Rregullore.
2. Punë me orar të plotë konsiderohet puna me kohëzgjatje javore prej dyzet (40) orësh.
3. Për punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, kohëzgjatja në orë e orarit të punës përcaktohet në kontratën e punës.
4. Për punën me orar jo të plotë, e drejta në pagë bazë zbatohet duke u përpjesëtuar në proporcione orarin e punës, të përcaktuar në kontratën e punës.
5. Raporti i koeficienteve është pesëpikë dyzet e pesë me njëmbëdhjetë pikëtëdhjetë e një (5.45:11.81), të shpërndarë nëkatëmbdhjete (14) nivele të koeficienteve, të përcaktuar në shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregullore.
6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune.
7. Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me vendim të veçant nga Bordi i Drejtoreve të NPL-së në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të NPL-së të përgatitur dhe të zbuluar nga Komisioni i Auditimit sipas nenit 20.4 të këtij ligji për Ndërmarrjet Publike.
8. Vlera monetare e koeficientit e përcaktuar sipas kësaj Rregullore, mund të ulet vetëm me vendim të veçant nga Bordi i Drejtoreve të NPL-së në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të NPL-së të përgatitur dhe të zbuluar nga Komisioni i Auditimit sipas nenit 20.4 të këtij ligji për Ndërmarrjet Publike, për situatat si në vijim:
 - 8.1 një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe të hyrave vetanake të NPL-së;
 - 8.2 një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 8 Llogaritja e pagës

1. Paga llogaritet çdo muaj, nga Ndërmarrja Publike Lokale "Eko-Theranda" Sh.A. në raport me orarin e përcaktuar të punës, konkretisht në raport me orët e realizuara të punës dhe rregullat e përcaktuara përgjatë kësaj Rregullore dhe Rregullorespërkates për orarin e punës si dhe legjislacionin relevant në fuqi.
2. Për efekt të llogaritjes të pagës mujore, një (1) ditë pune llogaritet të ketë tetë (8) orë pune.
3. Vlera e pagës bazë (v), për punën e kryer me orar të plotë, llogaritet duke shumëzuar koeficientin për orë pune (x), më orët e realizuara përgjatë muajit (y), me vlerën monetare të koeficientit (z).

$$V = X * Y * Z$$

4. Paga paguhet për çdo muaj, nëpërmjet sistemit të pagave duke transferuar mjetet në llogaritë personale bankare, më së voni në ditën e fundit të punës së muajit.
5. Për qëllim të kësaj Rregullore dhe përfekte tatimore, paga bazë dhe shtesat e aplikueshme konsiderohen si pagë primare.
6. Për qëllim të kësaj Rregullore dhe përfekte tatimore, shpërblimi konsiderohet si pagë sekondare.

Neni 9
Shtesat pér ngarkesat e posaçme nē punë

1. Të punësuarit kanë të drejtë nē shtesat pér ngarkesat e posaçme nē punë, ndikimin negativ të ambientit, irreziqet nē punë, si dhe pér punë tē pa përshtatshme pér punëtorin.
2. Shtesat llogariten vetëm pér kohën gjatë së cilës i punësuari ka punuar nē kushtet me të cilër. i takon shtesa.
3. Bazë pér caktimin e shtesave, është paga bazë e të punësuarit me orar tē plotë tē punës.
4. Pér punën më të gjatës e orari i plotëi punës, si dhe pér punë nē ditët e festave shtetërore dhe pér punën e natës, i punësuari ka të drejtë nē pagë shtesë, duke u bazuar nē Ligjin e Punës, me këtë Rregullore dhe Kontratën e Punës.
5. Të punësuarit i takon paga shtesënë përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
 - 5.1 20 % nē orë pér kujdestari;
 - 5.2 30 % nē orë pér punë gjatë natës;
 - 5.3 30 % nē orë pér punë jashtë orarit;
 - 5.4 50 % nē orë pér punë gjatë ditëve të festave; dhe
 - 5.5 50 % nē orë pér punë gjatë fundjavës;
6. Pagesa shtesë pér punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve tē lira sipas ligjit e përjashtojnjenjera-tjetrën.
7. I punësuari mund tē kërkojë nga punëdhënësi që nē vend tē pagës shtesë, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.
8. Punëdhënësi mund tē vendosë që një pjesë tē punës jashtë orarit tē kompensohet me ditë pushimi, nē përputhje me përqindjet e parapara nē paragrafin 2 tē këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet tē parashihet nē Kontratën e Punës ose nē Aktin e Brendshëm tē Kompanisë.

Neni 10
Kompensimi i pagës

1. I punësuari ka të drejtë pér kompensim nē pagë, nē rastet si nē vijim:
 - 1.1. gjatë ditëve të festave nē të cilat nuk punohet;
 - 1.2. gjatë kohës së shfrytëzimit tē pushimit vjetor;
 - 1.3. gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale pér të cilën është dërguar;
 - 1.4. gjatë ushtrimit tē funksioneve publike pér të cilat nuk paguhet.

Neni 11
Kompensimi i pushimit mjekësor

1. I punësuari nē rast tē sëmundjes ka të drejtë nē pushim mjekësor tē rregullt mbi bazën, der. nē njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % tē pagës.
2. I punësuari ka të drejtë nē kompensim tē pushimit mjekësor që është si pasojë e lëndimit ose sëmundjes profesionale nē punë e cila ndërlidhet me kryerjen e punëve dhe tē shërbimeve pér punëdhënësin me kompensim prej 70 % tē pagës së tij nē kohë zgjatje deri nē nëntëdhjetë (90) ditë pune, pas raportit te mjekut specialist.
3. Pagesa pér kompensimin e pushimit mjekësor bie mbi punëdhënësin.
4. Të drejtat e përcaktuara sipas këtij neni mund tē parashihen edhe me Kontratën Këlektive, Aktine Brendshëm, por nē as një rast nuk duhet tē jenë më tē ulëta se sa të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Neni 12

Kompensimi i transportit për punëtorët e bartur në një vend tjetër të punës

Në raste të sistemimit të punëtorëve nga një vend në vendin tjetër të punës nga Neni 17 pika 3 e Ligjit të Punës, punëdhënësi kompenson të gjitha shpenzimet e transportit publik të të punësuarit.

Neni 13

Kompensimi në rast të pensionimit

I punësuari me rastin e pensionimit gjëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej 2 paga mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit. Kjo vlen vetëm për të punësuarit e rregullt ndërsa nuk vlen për të punësuarit me kontrata të përkohshme.

Neni 14

Ndihma solidare me rastin e vdekjes se punëtorit

Ndihma solidare të punësuarit do ti paguhen në rast të vdekjes së punëtorit ka të drejtë në ndihmën solidare të tri (3) paga bazë që i ka marrë për tre muajt e fundit.

Neni 15

Kompensimi i pushimit të lehonisë

1. Femra e punësuar gjëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë.
2. Me prezantimin e certifikatës mjekësore femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej njëzetetë (28) ditëve paratës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlgjime femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë detyrate saj.
3. Gjashtë (6) muajte parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë.
4. Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë.
5. Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjera pa pagesë.

Neni 16

Kompensimi i lëndimit në punë

Punëdhënësi është i obliguar qënë rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit të shkaktuar gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas ligji të Punës dhe kësaj rregulloreje, si dhe ligjeve tjera të aplikueshm e si dëshmi duhet të sillet raporti mjekësor mbi konstatimin nga mjeku specialist.

Neni 17

Kompensimi i punëtorëve me gjendje të rendë shëndetësore dhe të pa shërueshme

Deri në zgjidhjen e çështjes sociale, për punëtorët me gjendje shëndetësore të rendë, të konstatuar me dëshmi nga komisioni mjekësor, i bëhet kompensimi të ardhurave në kohë zgjatje deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune, prej 70 % të pagës bazë së tij.

Neni 18
Kompensimi për mos shfrytëzimin e pushimit vjetor

1. Të punësuari nuk mund t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor.
2. I punësuari që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese deri në fund të muajit të gjashtë (6) të vitit vijues, e cila i konvenon punëmarrësit, apo kompensim me të holla.
3. Lartësia e kompensimit nga paragrafi 2 i këtij nenit, caktohet varësisht nga kohë zgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuari i realizon përmes kur kompensohet.

Neni 19
Kompensimin e shpenzimeve te udhëtimit zyrtar jasht vendit

1. Të punësuarëve në NPL-në "Eko-Theranda" Sh.A, iu takon kompensimi i shpenzimeve për udhëtim zyrtar kur kryejnë punë në kuadër të detyrave të tyre të purës për Ndërmarrjen.
2. Kryeshefi Ekzekutiv vendos për personat të cilët do të udhëtojnë zyrtarisht në kuadër të projekteve ose nevojave të tjera që paraqiten në kuadër të afarizmit dhe politikave zhvillimore të NPL "Eko-Theranda" Sh.A. Suharekë.
3. Urchëresa për udhëtim zyrtar duhet të përmban këto shënimë:
 - 3.1 emri dhe mbiemri i të punësuarit qe udhëton;
 - 3.2 punët dhe detyrat e punës qe duhet të kryhen;
 - 3.3 vendi dhe shteti ku duhet udhëtar;
 - 3.4 koha e nisjes dhe kohëzgjatja e udhëtimit;
 - 3.5 mjeti i udhëtimit që do të përdoret për udhëtim;
 - 3.6 lartësia e akontacionit dhe të dhënat tjera eventuale të nevojshme;
4. NPL-ja "Eko-Theranda" Sh.A. Suharekë, do t'i paguaj të punësuarit shpenzimet për udhëtim zyrtar të cilat përfshijnë transportin, fjetjen dhe shujtat për udhëtime pune.
5. Ditet të plotësohen kushtet që të kualifikohet shpenzimi për punë si:
 - 5.1 Udhëtimi për punë duhet të jetë i autorizuar me shkrim nga niveli i duhur menaxherial;
 - 5.2 Duhet të ceket qartë qëllimi i udhëtimit për punë;
 - 5.3 Kërkesa për udhëtim duhet të jetë në harmoni me politikat e pagesave të udhëtimit të punëdhënësit;
6. Udhëtimet zyrtare jashtë Kosovës kompensohet sipas procedurave të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfshinësimit dhe vendimit të Ministarisë së Financave me numër te protokollit 01-Nr.1214 i datës 20.06.2018, që varet nga shteti ku bëhet udhëtimet zyrtare.

Neni 20
Shpenzimet e transportit

1. Shpenzimet e transportit të udhëtimit zyrtar kompensohen në vlerën 100 % të shpenzimeve faktike të dëshmuara me biletat e transportit publik ose në formë tjetër.
2. Nëse punëmarrësi e shfrytëzon automjetin privat për udhëtim zyrtar i paguhet kompensimi i shpenzimeve të deriveve 0,13 € për kilometër.

Neni 21

Shpenzimet e sigurimeve mjekësore, vizave, thirrjeve telefonike

Kur ato janë të domosdoshme bien në barrë të NPL "Eko-Theranda" Sh.A. Suharekë.

Neni 22

Pjesëmarrja ne seminare, kongrese e takime

1. Pjesëmarrja në seminare, kongrese dhe trajnime, mund të bëhen vetëm në raste kur të njëjtat organizohen në kuadër të lëmisë të fushë veprimitarisë së Ndërmarrjes.
2. Të gjitha shpenzimet i mbulon ndërmarrja.

Neni 23

Shpenzimet për ndihma solidare financiare pa obligim kthimi

Në rast të sëmundjes së rëndë të punësuarit, apo fatkeqësive natyrore, apo në bazë të kërkesës së të njëjtëve mund t'i u jepet pa kthim ndihma solidare financiare, të cilën vlerë e përcakton Bordi i Drejtoreve i Ndërmarrjes, varësisht nga rasti dhe gjendja financiare e Ndërmarrjes, por kjo nuk mund të kaloj më shumë se dy (2) paga bazë të të punësuarit.

Neni 24

Shpenzimet me rastin e festave të fund vitit, fetare dhe kombëtare dhe donacionet për palët e treta

1. Varësisht nga gjendja financiare e Ndërmarrjesë dhe në pajtim me propozimin e Menaxhmentit të Ndërmarrjesë, pas aprovimit nga Bordi i Drejtoreve, të punësuarëve të Ndërmarrjes mund të ju ndahen mjete financiare me rastin e festave fetare, kombëtare, festave të fund vitit dhe për rastin e përgatitjeve për fillim-vitin e ri shkollor.
2. Ndërmarrja mund të jetë donator i ndonjë projekti sipas kërkesës se palëve të treta (individë ose persona juridik), por ky donacion nuk mund të kaloj vlerën e një page mujore mesatare të punëdhënësit.
3. Ndërmarrja mund të jetë donator i ndonjë projekti të ndonjë OJQ-je ose grupe tjera të organizuara interesë si sportiv, edukativ, me karakter garues etj., për realizimin e ndonjë projekti të rëndësishëm, por ky donacion nuk mund të jete me i madh se 10% e vlerës së përgjithshme të vet projektit të paraparë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

1. Në asnjë rast dispozitat e kësaj Rregullore nuk mund të janë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësit, se dispozitat e Ligjit të punës ose kontratës kolektive, për sa u për ketë të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës.
2. Çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë rregullore do të rregullohen në bazë të Ligjit të Punës dhe akteve tjera nënë ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 26

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Bordi i Drejtoreve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Theranda" në Suharekë, me propozimet e arsyetuara me shkrim nga propozuesi.

Neni 27
Zbatueshmeria

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. me seli në Suharekë, konkretisht Bordi i Drejtoreve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjesë në fjalë.

Neni 28
Shtojcat e Rregullores

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është shtoja si në vijim:
2. Shtoja Nr. 1 – Të punësuarite Ndërmarrjesë Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. me seli në Suharekë.

Neni 29
Shqyrtimi i përputhshmërisë

Kjo rregullore pas miratimit nga Bordi i Drejtoreve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, i nënshtronet shqyrtimit të detyrueshëm te përputhshmërisë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për të siguruar se Rregullorja në fjalë është në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikanë Kosovës.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 5, (pesë) ditë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ëeb-faqen e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë

B O R D I I D R E J T O R È V E





KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



NPL "EKO-THERANDA"
SH.A. SUHAREKË

SHTOJCA NR.1

Kjo shtojca cështë pjesë e rregullores për pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet të tjera të punonjësve të ndërmarrjes publike lokale "Eko Theranda" sh.a.

Struktura organizative dhe pozitat


Neni në Rregulloren e Brendshme	Përshkrimi
3.1	Kryeshefi/e Ekzekutiv;
3.2	Zyrtari/e Kryesor Financiar dhe i Thesari;
3.3	Sekretar i/e Përgjithshëm;
3.4	Zyrtar i/e auditimit të Brendshëm;
3.5	Zyrtar i/e Prokurimit
3.6	Zyrtar e për Burime Njerëzore
3.7	Zyrtar e për Logistikë;
3.8	Depoist/e;
3.9	Arkëtari/e ;
3.10	Inkasanti/e;
3.11	Zyrtar e për regjistrimin e pasurive
3.12	Zyrtar e administrative
3.13	Zyrtar për mbrojtje të mjedisit
3.14	Shërbimi i mirëmbajtjes;
3.14.1	Kryepunëtor/e
3.14.2	Punëtor/e Fizik për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe pastrimin e objekteve;
3.14.3	Punëtor/e Sigurim Fizik-Roje;
3.14.4	Shtëpiaku/e;
3.14.5	Vozitës i/e mjeteve të punës;
3.14.6	Vozitës i/e mjeteve të renda.



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



NPL "EKO-THERANDA"
SH.A. SUHAREKË

KOEFICIENTET E PAGAVE

Neni në Rregulloren e Brendshme	Përshkrimi	Koeficienti
3.1	Kryeshefi/e Ekzekutiv;	11.81
3.2	Zyrtari/e Kryesor Financiar dhe i Thesari;	8.0
3.3	Sekretar i/e Përgjithshëm;	8.0
3.4	Zyrtar i/e auditimit të Brendshëm;	7.5
3.5	Zyrtar i/e Prokurimit	7.0
3.6	Zyrtar/e për Burime Njerëzore	7.0
3.7	Zyrtar/e për Logistikë;	7.0
3.8	Depoist/e;	6.0
3.9	Arkëtari/e ;	6.0
3.10	Inkasanti/e;	6.0
3.11	Zyrtar/e për regjistrimin e pasurive	6.0
3.12	Zyrtar/e administrative	6.0
3.13	Zyrtar për mbrojtje të mjedisit	7.0
3.14	Shërbimi i mirëmbajtjes;	
3.14.1	Kryepunëtor/e	6.5
3.14.2	Punëtor/e Fizik për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe pastrimin e objekteve;	5.45
3.14.3	Punëtor/e Sigurim Fizik-Roje;	5.45
3.14.4	Shtëpiaku/e;	5.45
3.14.5	Vozitës i/e mjeteve të punës;	5.91
3.14.6	Vozitës i/e mjeteve të renda.	7.0